



Datë: 10.11/2025
Numër Protokolli: 7310/2025

A.nr.1652/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1652/2025, të datës 02.09.2025, të parashtruar nga ankuesja T.K.H, nga Fushë Kosova, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*masë disiplinore-vërejtje me shkrim*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 10.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa më numër A.nr.1652/2025, e datës 02.09.2025, e parashtruar nga ankuesja, T.K.H.

II. Shfuqizohet Vendimi me numër protokolli 05-6170, i datës 14.08.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin ankueses si në piken I të dispozitivit të këtij vendimi i është shqiptuar masa disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”.

III. Obligohet Udhëheqësja e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, për zbatimin e këtij vendimi në afat prej pesëmbëdhjete (15) ditësh nga dita e pranimi të tij, duke larguar masën disiplinore nga dosja personale e ankueses.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile, T.K.H (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), më datë 02.09.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5864/2025 të regjistruar nën shenjë A.nr.1652/2025, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 05-6170 të datës 14.08.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin ankueses i është shqiptuar masa disiplinore “Vërejtje me shkrim”.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli), bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 08.09.2025 dhe më datë 09.10.2025 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Shëndetësisë përkatësisht kërkesën për prova shtesë te ky Institucion, ndërsa kjo e fundit më datë 12.09.2025, ka dorëzuar përgjigjen me provat e bashkangjitura të lëndës sipas kërkesës së datës 08.09.2025 dhe poashtu më datë 13.10.2025, përgjigjen në lidhje me kërkesën e datës 09.10.2025.

Kryetari i Këshillit, me datë 07.10.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokolli: 6647/2025, përmes të cilit ankesës së ankueses nën shenjë A.nr.1652/2025 të datës 02.09.2025, i’ a ka vazhduar afatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5864/2025 të datës 02.09.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshill; Vendimin me numër protokolli 05-6170 të datës 14.08.2025; E-mailin e datës 01.08.2025, me komunikimin prej 2 faqeve; E-mailin e datës 04.08.2025, me komunikim prej 4 faqeve; E-mailin e datës 04.08.2025, me komunikim prej 2 faqeve; E-mailin e datës 05.08.2025, me komunikim prej 2 faqeve; E-mailin e datës 05.08.2025; Rekomandim i për pagesë të datës 04.08.2025; E-mailin e datës 06.08.2025, me komunikim prej 6 faqeve; E-mailin e datës 06.08.2025, me komunikim prej 3 faqeve; Vendimin me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025; E-mailin e datës 05.08.2025, me komunikim prej 6 faqeve; Kërkesën me numër protokolli 05-4289/2 të datës 13.09.2023; Përgjigjen në kërkesë me numër protokolli 05-4289 të datës 14.07.2023; Raportin me numër protokolli 05-4195 të datës 11.07.2023; Shkresën për veprim “Ndërtimi QKMF-së në Ferizaj” të datës 31.07.2025; E-mailin e datës 05.08.2025; Aktivitetet në proces-Kontratat për pune; Dokument identifikimi i ankueses; Vendimin me Nr.R.MSH 20/2024 të datës 11.11.2024; Hartimin e specifikave Teknike/Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit “Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas”, me numër protokolli 05-5945 të datës 07.08.2025, prej 4 faqeve; Kërkesën për fillimin dhe realizimin e procedurave të Prokurimit për përzgjedhjen e Operatorit Ekonomik për kryerjen e ekspertizës për projektin “Ndërtimi i QKMF-së në Drenas”; Deklaratat nën betim të datës 06.08.2025, të ankueses, të Sh.O, të Sh.U dhe N.Zh; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 12.09.2025; Akt emërimit me numër protokolli 05-10048 të datës 23.12.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës, për pozitën Zyrtar i Lartë për Planifikim Infrastrukturor; Vendimin me Nr.536/VII/2025 të datës 28.07.2025, dhe numër protokolli 05-5715 të datës 29.07.2025; E-mailin e datës 06.08.2025, me komunikim prej 3 faqeve; E-mailin e datës 05.08.2025; Raportin e datës 05.08.2025, prej 3 faqeve; E-mailin e datës 07.08.2025; Kërkesën për prova të datës 09.10.2025; Përgjigjen në kërkesë të datës 13.10.2025; E-mailin e datës 01.08.2025; Vendimet e aprovuara dhe refuzuara, të pushimeve

vjetore të ankueses për vitin 2025; Akt emërimin me numër protokolli 05-10105 të datës 24.12.2024; Vendimin me Nr.R.MSH.31/2024 të datës 11.11.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës, për pozitën Udhëheqës i Divizionit të Kujdesit Parësor Shëndetësor; Akt emërimin me numër protokolli 05-10024 të datës 23.12.2024; Vendimin me Nr.R.MSH 10/2024 të datës 11.11.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës, për pozitën Zyrtar i lartë i Burimeve Njerëzore; Akt emërimin me numër protokolli 05-166 të datës 13.01.2025; Vendimin me Nr.R.MSH 27/2024 të datës 11.11.2024; Formularin e përshkrimit të detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për licencim të Institucioneve Shëndetësore; Akt emërimin me numër protokolli 05-10049 të datës 23.12.2024; Vendimin me Nr.R.MSH 91/2024 të datës 11.11.2024; Formularin për përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar për Bashkëpunim me Drejtoritë Komunale për Shëndetësi; Raportin për prezencën në punë të V.H, për muajin Korrik dhe Gusht të vitit 2025; Vendimet e aprovuara për pushim vjetor, mjekësor, udhëtime zyrtare dhe të tjera, të V.J.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të dorëzuara nga palët në procedurë si dhe pretendimeve ankimore të ankueses konstatoi se ankesa **është e bazuar, sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës konstatohet se ankuesja sipas Akt emërimit me numër protokolli 05-10048 të datës 23.12.2024, është e punësuar në pozitën e *Zyrtares së Lartë për Planifikimin Infrastrukturor*, në Departamentin për Planifikim Strategjik Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë.

Më tej nga shkresat e lëndës rezulton se Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, përmes Vendimit me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025, ka emëruar Grupin Punues për Hartimin e Specifikimeve teknike/Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit: “Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas”, rrjedhimisht në cilësinë e kryesueses e ka emëruar ankuesen, ndërsa në cilësinë e anëtarëve ka emëruar këta zyrtar: z.Sh.O, znj.V.P, znj.Sh.U si dhe znj.N.Zh.

Sipas pikës II të dispozitivit të Vendimit me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025, Grupi punues, është obliguar që të hartoj Specifikimet Teknike/Termet e Referencës në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik.

Sipas pikës III të dispozitivit, përgjegjësit e Grupit Punues janë përcaktuar që të hartojnë specifikimet teknike/TeR: a) në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe t drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik, në përputhje me nenin 28 të Ligjit të Prokurimit Publik, Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 dhe legjislacionin e tij implementues; b) në atë mënyrë që nuk favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operator ekonomik; c) të cilat nuk i referohen një artikulli ose burimi të veçantë, ose një procesi të hollësishëm, ose ndonjë shenjë dalluese, lloji ose origjine të veçantë ose ndonjë prodhimi. Ndërsa, sipas pikës IV të dispozitivit, Grupi punues është obliguar që të hartojë specifikimet teknike/TeR deri më datë 04.08.2025, të bëjë hulumtimin e çmimeve të tregut dhe të inicojë procedurën e prokurimit, si dhe ndër të tjera sipas V, Grupi punues është obliguar që së bashku me specifikimet teknike/TeR të dorëzoj edhe Deklaratën e

nënshkruar nën betim, si dhe sipas pikës VI, është shfuqizuar Vendimi me numër protokolli 05-5715, i datës 29.07.2025.

Tutje, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë përmes Vendimit Nr.602/VIII2025 dhe me numër protokolli 05-6170 të datës 14.08.2025, i ka shqiptuar ankueses masën disiplinore “*Vërejtje me shkrim*”, të përcaktuar sipas nenit 57 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3, me arsyetimin se Grupi punues i udhëhequr nga ankuesja nuk i ka kryer detyrat dhe përgjegjësit sipas Vendimit të lartë theksuar përkatësisht Vendimit me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, gjegjësisht dokumentacioni i dorëzuar nga grupi përkatës nën udhëheqjen e së njëjtës nuk ka përmbushur kërkesat e përcaktuara dhe as afatin e vendosur e që ishte data 04.08.2025, duke shkaktuar kështu vonesa të drejtpërdrejta në hartimin e specifikimeve teknike dhe termave të referencës për aktivitetin e prokurimit ” Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas, si dhe duke bërë një propozim financiar të pabazuar, sa i përket angazhimit të kompanisë që do të kryente ekspertizën në lidhje me projektin si më lartë të potencuar.

Ankuesja, kundër Vendimit Nr.602/VIII2025 dhe me numër protokolli 05-6170 të datës 14.08.2025 të nxjerrë nga Sekretari i Ministrisë së Shëndetësisë, brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se vonesa ka qenë minimale, përkatësisht dokumentacioni i plotë është dorëzuar me datë 06.08.2025, vetëm dy ditë pas afatit të përcaktuar, dhe se nuk është shkaktuar asnjë pengesë apo pasojë për Institucionin, ngase sipas ankueses vendimi për emërimin e së njëjtës në cilësinë grupit punues i është dorëzuar me datë 01.08.2025, ditë e premte, në ora 13:04, ndërsa afati për dorëzimin ka qenë me datë 04.08.2025, ditë e hënë, rrjedhimisht e njëjta pretendon se ka pasur afat për kryerjen e një detyre komplekse vetëm një ditë e gjysmë, ngase data 02 dhe 03 ka qenë ditë vikendi (e shtune dhe e diele), duke shtuar faktin se po ashtu gjatë këtyre ditëve ka pasur e-maila nga eprorët për punë tjera, respektivisht nga Udhëheqësi i Divizionit dhe Drejtori i Departamentit. Ndërsa, lidhur me dëmtimin e buxhetit të shtetit ankuesja pretendon se lidhur me ekspertizën e objektit me sipërfaqe 4.250 m², dhe me qëllim të hulumtimit të tregut me datë 04.08.2025, ka kontaktuar disa pika referente, përfshirë edhe përfaqësues nga Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës, mirëpo që në Kosovë nuk ekziston ndonjë tarifë fikse zyrtare për këtë shërbim, andaj thekson se vlerësimi prej 20.000 Euro është një shumë e arsyeshme, krahasuar me tregun ku kostoja reale mund të variojë nga 25.000 Euro e më lartë, dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet dëmtim i buxhetit të shtetit, por mbrojtje e tij. Më tej, e njëjta thekson se masa disiplinore i është shqiptuar në periudhën kohore, kur e njëjta ka qenë në pushim vjetor të miratuar, dhe atë nga data 11.08.2025 deri më 22.08.2025, duke pretenduar se me këtë rast nuk është marrë për bazë kjo rrethanë dhe as e drejta e informimit. Ndër të tjera, shton se arsyetimi i vendimit të kundërshtuar me ankesë është i njëanshëm dhe nuk ka marrë parasysh faktin se detyrat e përcaktuara në këtë vendim kanë qenë të natyrës kolektive, dhe realizimi i tyre ka qenë i varur nga bashkëpunimi i të gjithë anëtarëve të grupit punues. Si rrjedhojë, ankuesja kërkon nga Këshilli, konstatimin se masa disiplinore e shqiptuar është e pabazuar në fakte dhe në ligj, rrjedhimisht shfuqizimin e të njëjtit akt dhe garantimin e së drejtës për trajtimin e drejtë dhe proporcional.

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit dhe vërtetimit të pretendimeve ankimore të ankueses, dhe me rastin e vendimmarrjes mori për bazë dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik lidhur me përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, përkatësisht: Nenin 55, i cili përcakton se: “1. Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen

detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim, Nenin 56 paragrafi 1, 2 dhe 3, ku përcaktohet se: 1. Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. 2. Shkeljet e rënda të detyrave dhe përgjegjësi të punës janë të përcaktuara me ligj, ndërsa shkeljet e lehta janë të përcaktuara me ligj dhe rregulla të brendshme. 3. Shkelje të lehta konsiderohen: 3.1. mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune radhazi; 3.2. mosrespektimi i orarit të punës; 3.3. sjellja jo e mirë gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit/it, koleget/ët, vartëset/it dhe me publikun, Nenin 57 paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunës/it civil për shkelje të lehta janë: 1.1. vërejtje verbale; 1.2. paralajmërim me shkrim; 1.3. vërejtje me shkrim.; si dhe, Nenin 58, paragrafi 1, ku përcaktohet se: 1. Masat disiplinore për shkeljet e lehta shqiptohen nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe/apo nga udhëheqësja/i më i lartë administrativ.

Rrjedhimisht, bazuar në kuadrin ligjor si më sipër dhe shkresat e bashkangjitura të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses për afat të shkurtër për përfundimin e detyrave dhe obligimeve të përcaktuara nga Vendimi me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, është i bazuar, ngase e njëjta vendimin për emërimin e saj në cilësi të kryesueses së Grupit Punues për Hartimin e Specifikimeve teknike/Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit: “Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas”, e ka pranuar përmes e-mailit të dërguar me datë 01.08.2025 (ditë e premte), në ora 01:04, nga zyrtarja E.P, dhe duke marrë parasysh se datat 01 dhe 02.08.2025, kanë qenë ditë pushimi- e Shtune dhe e Diele, ndaj si rrjedhojë e kësaj gjendje faktike, në vlerësimin e Kolegjit të Këshillit, afati kohor për përfundimin e këtyre detyrave dhe obligimeve për një periudhë kaq të shkurtër kohore, gjegjësisht deri më datë 04.08.2025, e bën të qëndrueshëm pretendimin ankimor të ankueses për pamundësinë e kryerjes së obligimit që ka rrjedhë sipas vendimit të potencuar si më lartë.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në Vendimin me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025, për emërimin e Grupit Punues për Hartimin e Specifikimeve teknike/Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit: “Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas”, me rastin e vendimmarrjes, mori për bazë edhe nenin 19, nën paragrafin 19.16 të Rregullores Nr.002/2024 për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se: “ZKA do ta emërojë një person/ekip nga Njësia Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, për hartimin e specifikimeve teknike. Personi/ekipi i emëruar se bashku me Specifikimet teknike do të plotësoj dhe dorëzojë një Deklaratë nën Betim.....”, që nënkupton se me rastin e emërimit të grupit punues që ka pas obligimet konformë vendimit të potencuar si më lartë, është obligim që derivon nga ky plotësim i këtij akti nënligjor, që anëtarët e këtij grupi duhet të plotësojnë kriteret që kërkohen sipas kësaj rregullore, ndërsa nga shkresat e bashkangjitura të lëndës rezulton se në këtë grup janë caktuar anëtarë pa shkathtësi dhe përvojë të duhur lidhur me kryerjen e detyrave përkatëse, më konkretisht ky konstatim mbështetet në përgjigjet e anëtareve ndaj e-mailit të ankueses të datës 05.08.2025, lidhur me analizimin e raportit duke plotësuar apo eventualisht propozuar ndryshimin e tij, respektivisht të anëtares znj Sh.U, e cila në e-mailin e datës 06.08.2025, ka deklaruar se do të jap kontributin e saj bazuar në njohuritë edhe pse nuk i takon Njesisë

Kërkuese dhe nuk ka shkathtësi dhe përvojën e duhur, si dhe në e-mailin e bashkangjitur të anëtarit z. Sh.O, ku rezulton se i njëjti ka theksuar i bashkëngjitëm shkresës së znj. Sh.U, duke shtuar se do të jap kontributin por se nuk ka asnjë përgatitje apo trajnim paraprak në këtë fushë, dhe se për më tepër, Kolegji i Këshillit, nga shkresat e lëndës ka konstatuar se njëra anëtare e këtij Grupi, përkatësisht znj. V.P, me datën e njoftimit lidhur me emërimin e së njëjtës anëtare në grupin përkatës punues, gjegjësisht me datë 01.08.2025 ka qenë në pushim mjekësor, ndërsa nga data 06-08.08.2025, e njëjta ka qenë në udhëtim zyrtar, dhe që përmes këtij fakti edhe mund të nxjerrët përfundimi që përgjegjësia nuk ka qenë proporcionale sa i përket finalizimit të këtij projekti si ekip i përbashkët, nga se përveç joprofesionalizmit të disa anëtarëve të komisionit gjithashtu siç u tha më lartë njëra nga anëtarët e komisionit ishte në pushim mjekësorë në datën e potencuar më lartë, e që këto rrethana shkaktajnë pengesa në punën ekipore, sidomos kur obligimet janë profesionale dhe të afatizuara, ndërsa Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe faktin se ankuesja përmes kësaj ankese ka dorëzuar edhe shkresa/emaila që gjatë kësaj periudhë që ndërlidhet me finalizimin e projektit të ngarkuar sipas vendimit të potencuar më lartë ,ka pasur edhe obligime tjera zyrtare që ndërlidhen me përshkrimin e detyrave të punës që dalin nga aktemrimi , e që bazuar në arsyet si më lartë konstatohet fakti se ankueses nuk mund të i ngarkohet përgjegjësia për vonesë dhe planifikime joadekuate nga se kjo rrethanë nuk ka mundë të argumentohet nga zyrtari, në këtë rast Zyrtari Kryesor Administrativë që i ka shqiptuar masën disiplinore dhe poashtu edhe nga përgjigjja nga organi i punësimit nuk është dokumentuar një rrethanë e tillë.

Theksuar si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimi ankimor i ankueses, se detyrat e përcaktuara në këtë vendim kanë qenë të natyrës kolektive, dhe realizimi i tyre ka qenë i varur nga bashkëpunimi i të gjithë anëtarëve të grupit punues, është i bazuar, ngase e njëjta nuk e ka vet emëruar grupin përkatës, dhe si e tillë ankuesja për mungesën e përvojës profesionale dhe shkathtësive të anëtarëve tjerë të grupit përkatës, nuk mund të lihet përgjegjëse, ndërsa pavarësisht kësaj dhe afatit të shkurtër kohor, për kryerjen e detyrave dhe obligimeve të dala nga Vendimi me Nr.540/VII/2025 të datës 30.07.2025, dhe numër protokolli 05-5795 të datës 01.08.2025, të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, dokumenti *“Hartimi i specifikave Teknike/Termave të Referencës për aktivitetin e prokurimit “Angazhimi i ekspertizës profesionale për vlerësimin e projektit të ndërtimit të QKMF-së në Drenas”*, me numër protokolli 05-5945 të datës 07.08.2025, prej 4 faqeve, të nënshkruar përveç kryesueses/ankueses edhe tre anëtarët tjerë së bashku me deklaratat nën betim, i është përcjellë Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si më sipër, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër protokolli 05-6170 të datës 14.08.2025, i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë, me të cilin ankueses i është shqiptuar masa disiplinore *“Vërejtje me shkrim”*, është në nxjerrë përmes shkeljeve të ligjit material dhe vërtetimit jo të plotë të gjendjes faktike, gjegjësisht në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, ngase përveç tjerash me të njëjtin akt nuk është përcaktuar se cilën nga shkeljet e lehta disiplinore të përcaktuara nga neni 56, paragrafi 3 i LZP-së hy kjo shkelje dhe se me cilat veprime apo mos veprimet e saj ka kryer ankuesja, në mënyrë që ti shqiptohet kjo masë e lehtë disiplinore sipas nenit 57 paragrafit 1.3 të këtij ligji, Kolegji i Këshillit Konstaton se bazuar në shkresat e lëndës ,ankueses i janë cenuar të drejtat që parashihen në Ligjin Nr.05/l -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Neni 95 paragrafi 1,2 dhe 3, që e rregullon të drejtën e dëgjimit në procedurën administrative, ku

specifikishtë parashihet: “1. Para marrjes së një vendimi përfundimtar, organi publik që zhvillon procedurën administrative, duhet të njoftojë palën për të drejtën e saj për t’u dëgjuar. 2. Njoftimi, i paraparë me paragrafin 1 të këtij neni, do të përshijë informacionin mbi rezultatet e shqyrtimit administrativ, rezultatin e mundshëm të procedurës si dhe informacionin mbi mënyrën e ushtrimit të së drejtës së dëgjimit. 3. E drejta për t’u dëgjuar mund të ushtrohet me shkrim apo gojarisht dhe regjistrohet në procesverbal nga organi publik...” e që në rastin konkretë bazuar në shkresat e lëndës nuk është konstatuar respektimi i këtyre dispozitave ligjore që rregullojnë procedurën në lidhje me veprimet administrative që mund të ndërmerren ndaj palës në këtë rast, poashtu akti që është goditur përmes kësaj ankese nuk ka mbështetje ligjore edhe në Nenin 48 të LPPA-së që ndërlidhet me arsyetimin e një akti administrativë, e që është e definuar në këtë mënyrë: “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”, ndaj për pasojë ky akt administrativ rezulton si i paligjshëm në kuptim të dispozitave të Ligji Nr.05/1 -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 dhe 1.5 ku përcaktohet se: “1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material”.

Kështu që, nga ajo që u tha si më lartë dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hynë në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.1652/2025, datë 11/10/2025

Atdhe GASHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses T.K.H;
- Udhëheqëses së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë;
dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.